

VENDIM
Nr. 410, datë 16.7.2025

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TE SHOQËRIA SHTETËRORE “KAYO” SHA,
TË PRONËS NR. 173, ME EMËRTIMIN “ISH-GRUPDEPO TË INDUSTRIKË”, DHE
TË PRONËS NR. 174, ME EMËRTIMIN “ISH-SHA AUTOREPARTI”, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 1066, BABRU, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim te shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., të pronës nr. 173, me emërtimin “Ish-grupdepo të industrisë”, dhe të pronës nr. 174, me emërtimin “Ish-sh.a. Autoreparti”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes (Komandës Mbështetëse), me vendndodhje në zonën kadastrale 1066, Babru, Tiranë, me qëllim përdorimin sipas objektit të veprimtarisë së shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a.

2. Shoqërisë shtetërore “KAYO” sh.a., i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit përtej objektit të saj të veprimtarisë, të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi ose t’i tjetërsojë pronat e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a., dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku